



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

**NJOFTIM PËR PUNËSIM**

Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Q.S.U "Nënë Tereza" kërkon të punësojë **1 (një) Përgjegjës Njesie pranë Njesisë së Rehabilitimit Neurofizilogjik**, në Klinikën e Rehabilitimit Fizioterapeutik, të Polit të Administrimit të Integruar të Spitalit Polivalent të QSU "Nënë Tereza".

**Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për Përgjegjës Njesie :**

- Arsimi i lartë në nivelin Mjek Fizioterapeut / Master Shkencor / Master Profesional ose nivel i njehsuar me to, në profilin Fizioterapi.. *Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;*
- Të paktën 3 vite pune në fushën për të cilën ka përfunduar Arsimin e lartë;
- Të paktën 3 vite pune në nivel përgjegjës/drejtues;
- Të njoh shumë mirë procedurat administrative;
- Njohuri të gjera sa i përket fushës së fizioterapise si dhe pershtatjen e teknikave fizioterapeute bazuar në diagnozat e pacientëve të Njesisë;
- Të organizojë dhe koordinojë punën në Njësi, ndarjen e përgjegjësiave dhe të detyrave; të jetë i aftë të orientojë punonjësit në varesi në përbushjen e detyrave në zbatim të udhëzimeve dhe strategjive të Spitalit;
- Siguron përdorimin efektiv të pajisjeve, mirëmbajtjen dhe respektimin e protokolleve përkatëse.
- Aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritete dhe respektuar afatet;
- Aftësi shumë të mira komunikimi.

**Për sa më sipër, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat në gjuhën shqipe si më poshtë:**

1. Kërkesa me shkrim e shoqëruar me fotokopje e dokumentit të identifikimit (ID)
2. Curriculum vitae (CV), në gjuhën shqipe
3. Diplomën/at e arsimit të lartë, të noterizuar/a
4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
5. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore  
(<http://www.qsut.gov.al/rreth-nesh-8/te-punosh-me-ne/procedurat-e-marrjes-ne-pune-ne-qsut/> )
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në CV dhe që lidhen me pozicionin për të cilin aplikon.

Depozitimi i aplikimeve do të bëhet pranë zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e QSU "Nënë Tereza" **deri më 03.09.2021 ora 16:30.**

Komunikimi për datën dhe orën e Intervistave do të bëhet nëpërmjet **e-mail**-it në CV e kandidatëve.

Të gjithë kandidatët fitues do të rivlerësohen në fund të kontratës 3 (tre) mujore.

**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**